



BASHKIA SELENICË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
DREJTORISA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, MJEDISIT DHE INVESTIMEVE.

NJOFTIM PUBLIK

MBI PARAQITJEN E KËRKESAVE PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE

Bashkia Selenicë njofton të gjithë qytetarët se, në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", si dhe ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, po kryhet evidentimi i familjeve që mund të jenë subjekt i privatizimit të banesave shtetërore.

Ftohen të gjithë qytetarët/familjet që banojnë në banesa shtetërore dhe që pretendojnë se plotësojnë kushtet ligjore për privatizim, të paraqesin kërkesën me shkrim pranë Bashkisë Selenicë.

Afati për paraqitjen e kërkesave: 7 ditë nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës që vërteton statusin e banesës dhe të drejtën e përdorimit të saj.

Për çdo informacion shtesë, qytetarët mund të paraqiten pranë Drejtorisë së Urbanistikës në Bashkinë Selenicë gjatë orarit zyrtar.

Ky njoftim bëhet me qëllim evidentimin dhe përditësimin e të dhënave për përfundimin e procedurave të privatizimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Selenicë, më **20.02.2026**

Për privatizimin e banesave shtetërore (sipas ligjit nr. 7652/1992 dhe ligjit nr. 9321/2004), qytetarët duhet të paraqesin këto dokumente:

✦ **Dokumentacioni bazë**

1. **Kërkesë me shkrim** drejtuar Bashkisë Selenicë.
2. **Certifikatë familjare** (gjendja civile aktuale).
3. **Kopje e kartës së identitetit** të kryefamiljarit dhe anëtarëve madhorë.
4. **Dokument që provon të drejtën e përdorimit të banesës**, si:
 - Kontratë qiraje me ndërmarrjen shtetërore / ish-ndërmarrjen,
 - Vendim strehimi,
 - Akt-dorëzim banese,
 - Çdo dokument tjetër zyrtar që provon marrjen në përdorim të banesës.
5. **Vërtetim nga Bashkia** që banesa është në fond banesash shtetërore (nëse disponohet në arkiv).
6. **Vërtetim që familja nuk ka përfituar më parë privatizim tjetër banese shtetërore.**
7. **Planimetri / dokumentacion teknik i banesës**
8. **Vërtetim për detyrimet financiare** (qira të papaguara, nëse ka).

✦ **Gjithashtu në raste te veçanta duhet:**

- Akt trashëgimie (nëse përfituesi fillestar ka ndërruar jetë).
- Prokurë e posaçme (nëse aplikon një përfaqësues).
- Dokumente shtesë nga arkivat e ish-ndërmarrjeve shtetërore.

KRYETARI

Nertil Bellaj

